



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 179 /2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Vlastimir Dimić kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Kaçanik, për shkak të vendosjes së posterave në afërsi të Qendrës së Votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 18.06.2012, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 16.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se më datën 16.06.2012, rreth orës 09:00 në Kaçanik, në shtyllën në hyrje të shkollës së mesme (Gjimnazi) “ Skënderbeu “ militantë të subjektit politik AAK, siç ka potencuar ankuesi nuk i kanë larguar posterët e kandidatit të tyre për Kryetar Komune Tahir Çaka. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë rast subjekti politik AAK ka bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore 13/2009 neni 7.1 pika b sipas së cilës ndalohet ekspozimi i çfarëdo lloj materiali në cilëndo qendër të votimit, ose brenda hapësirës prej 100 metrash përreth dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP).

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi dy fotografi .

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 17.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 18.06.2012, në ora 12:00.

PZAP, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK, sipas afatit të caktuar. Në përgjigjen në ankesë subjekti politik AAK potencon se nuk lejohet vendosja e materialit zgjedhor gjatë ditës së zgjedhjeve në vendin e caktuar, material ky i

larguar nga vendi i cekur më lart një ditë para ditës së zgjedhjeve. Konsiderojmë se kemi respektuar legjislacionin në fuqi, duke larguar materialin nga vendi i cekur më lart, njëkohësisht parashtruesi i ankesës nuk ka fakte se aj material ka ekzistuar aty edhe gjatë ditës së zgjedhjeve. Prandaj , përmes kësaj përgjigje i drejtohem Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që të refuzoj ankesën në fjalë dhe të njejtën të mos e cilësoj si shkelje sipas pretendimeve të ankuesit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Sipas ankesës së parashtruar në PZAP pala ankuese pretendon se në shtyllën e shkollës së mesme “ Skenderbeu” ku pretendohet se është edhe Qendër e Votimit, militantët e subjektit politik AAK nuk e kanë larguar posterat e vendosur të kandidatit të tyre për Kryetar Komune Tahir Çaka. PZAP-i vlerësoi se pretendimet ankimore se janë bërë shkeljet e potencuara në ankesë janë të pabazuara nga shkakut se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për tu vërtetuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar në ankesë, pasi që nga fotot e ofruara si dëshmi që gjenden në shkresat e lëndës nuk shihet qartë se ku janë të vendosura këto postera, si dhe nuk mund të identifikohet se ku mund të jetë objekti i shkollës së mesme “Skenderbeu” që supozohet se është Qendër e Votimit. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë dhe në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1të LZP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

A nr. 179 /2012 më datën 18.06.2012.

